



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA UJËSJELLËS KANALIZIME
FUSHË-ARREZ

Adresa: Fushe-Arrez, Pukë

VENDIM

NR. 356 . DATË. 14 . 09 . 2018

I AKSIONERIT TË VETËM

Në Fushe-Arrez, sot me datë. 14 . 09 . 2018, une, Fran Tuci ,Kryetarë i Bashkisë Fushe-Arrez ,përfaqesues si Aksioner i Vetem të aksioneve "Ujësjellës Kanalizime Fushe-Arrez" Sha,themeluar me datë.28.09.2001 në baze të kompetencave të parashikuara ne nenin 64/f të ligjit Nr.139/2015 date,17.05.2015"Për Veteqeverisjen Vendore",per shkak të ndarjes se re administrative-territoriale sipas Ligjit Nr.115/2014,prej se ciles Bashkia Fushe-Arrez ka në perberje edhe njesitë administrative të krijuara nga ish komunat: Qafe-Mali, Iballe,Blerim dhe Fierze dhe në zbatim të VKM Nr.63 date.27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" per riorganizimin e Ujësjellës Kanalizime Fushe-Arrez Sha,

V E N D O S A:

1.Miratimin e statutit të riorganizimit dhe funksionimit të "Ujësjellës Kanalizime Fushe-Arrez"Sha,sipas pikes 2/b/h/j të nenit 135 të Ligjit Nr.9901 datë.14.04.2008 dhe pikes 1,Kreu I dhe Kreu II,i VKM Nr.63 datë.27.01.2016.

2.Perberja e aksioneve me të drejte vote,vlera nominale per aksion dhe perqindja e pjesmarrjes është sipas përcaktimit të nenit 4 të statutit të "Ujësjellës Kanalizime Fushe-Arrez"Sha,miratuuar në piken 1 te ketij vendimi.

- Kapitali përbehet nga një kuote:	122.100.000 lekë
- Vlera e kapitalit të shlyer:	122.100.000 lekë
-Vlera nominale per aksion:	1000 lekë
- Numri i aksioneve me të drejte vote	122.100 aksione.

4.Ndryshimin e Këshillit të Administrimit,në bazë të nenit 135/2c dhe 158/1 të Ligjit nr.9901 datë.14.04.2008 i ndryshuar

- a- Largohet. Enkeleda Tonin Prendi
- b- Emerohet. Xhon Mhill Leka

5.Vendimi hyn në fuqi menjëhere dhe regjistrohet ne QKB nga administratori,Xhon Leka.

AKSIONARI I VETËM
BASHKIA FUSHE-ARREZ
KRYETARI
FRAN TUCI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA UJËSJELLËS KANALIZIME
FUSHË-ARRËZ**

Adresa: Fushë-Arrëz, Pukë nr tel 027123273 E-mail jetmir.qafa@hotmail.com

VENDIM

NR. 3565/1 Datë. 14.11.2018

I AKSIONERIT TE VETEM, BASHKIA FUSHE-ARREZ

Në Fushë-Arrëz sot me datë 14/11/2018, unë Fran Tuci kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz, përfaqësues i Aksionerit të vetem Bashkia Fushë-Arrëz të sha Ujësllës-Kanalizime Fushë-Arrëz, themeluar me datë 28/09/2001 në bazë të kopetencave të parashikuara në nenin 64/a të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 Për vetqeverisjen vendore, në zbatim të neneve 112, 135, 136 e vijues të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqërit tregtare, të ndryshuar, të pikës 1,2,3,4 e vijues të Kreut I, të pikës 2 e vijues të Kreut II të VKM Nr.63 datë 27.01.2016 Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pishem, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, për riorganizimin e sha, Ujësllës-Kanalizime Fushë-Arrëz.

VENDOSA

1. Fillimin e procedurave për zmadhimin e kapitalit themeltar me kontribute në natyrë të Ujësllës-Kanalizime Fushe-Arrez Sh.a **K19629304M**, nepermjet
 - a) Transferimit të aktiveve, detyrimeve dhe kapitaleve nga ndërmarrja Ujësllës-Kanalizime, Bashkia Fushe-Arrez me Nipt **K58811319A**.
 - b) Trasferimin e aktiveve të Ujësllësve dhe kanalizimeve që ndodhen në pasqyren financiare të Bashkisë Fushe-Arrez ose që rezultojnë nga inventarizimi fizik.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.
3. Vendimi të depozitohet në QKB nga Administratori Xhon LEKA.

Per Asamblene e Pergjithshme

Kryetari


